

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"PLATINUM GROUP"**

Ne Tirane sot me date 15.06.2020, ne mbështetje te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", te ligjit Nr. 7850 date 29.07.1994 "Për Kodin Civil te Republikës se Shqipërisë",

Shoqëria GPG COMPANY me NUIS J64324443V themeluar ne daten 12/01/1996 perfaqesuar ligjerisht nga ortaket e shoqërise si me poshte:

Paqsor Buzi, lindur me Lushnjene date 03/09/1970, me zotësi te plote për te vepruar, shtetas shqiptar, identifikuar sipas kartës se identifikimit me H00903078F.

Gezim Dani, lindur me Lushnjene date 08/04/1970, me zotësi te plote për te vepruar, shtetas shqiptar, identifikuar sipas kartës se identifikimit me H00408092A.

GPG Company vendos themelimin e Shoqërisë me Përgjegjësi te Kufizuar "PLATINUM GROUP" SHPK, me cilësinë e ortakut te vetëm duke përcaktuar te drejtat dhe detyrimet ne këtë statut si me poshtë:

**KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

NENI 1

Forma

- 1.1 Shoqëria "PLATINUM GROUP" Shpk (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ligjit Nr.7850 date 29.07.1994 "Për Kodin Civil te Republikës se Shqipërisë" si dhe gjithë legjislacionit Shqiptar ne fuqi.
- 1.3 Statuti është në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

NENI 2

Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i Shoqëriseeshtë "PLATINUM GROUP SHPK"
- 2.2 Shoqëria ka vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen dhe e caktuar nga ortaku i vetem.

NENI 3

Objekti i shoqërisë

3.1 Objekt i veprimtarise se shoqerise "PLATINUM GROUP" shpk eshte ne perputhje me legjislacionin tregtar aktual Shqiptar dhe do te jete:

1. Prodhimin e te gjitha llojeve te tabelave ndricuese dhe jo ndricuese, tabela me alukobond, punime plexiglassi, germa 3D, reklama ne seri, reklama elektronike, printime dhe brandim fasadash te brendshme dhe te jashtme, brandim automjetesh, skenografi, stenda dhe artikuj promocioni, tabela sinjalistike, etj. Importin e te gjitha lendeve te para, materialeve dhe pajisjeve per realizimin e produkteve te mesiperme, tregetin e tyre brenda vendit, si edhe eksportin e tyre ne vendet e tjera. Importin dhe prodhimin e artikujve te ndryshem promocionale, si stilolapsa, cakmak, bluza, kapele, dhe artikuj te tjere te kesaj natyre, si edhe tregetin e tyre brenda dhe jashte vendit. Importin e e ndricuesave te ndryshem. Led ose jo Led, dhe tregetin e tyre brenda dhe jashte vendit. Sherbime te ndryshme marketingu, si webdizajn, reklama televizive dhe radiofonike, printime te ndryshme, si kartivita, fletepalosje, banera, organizimaktivitete te ndryshme promocionale, etj. Projektme dhe zbatimme te ndryshme. Cdo veprimtari tjetër ligjore qe ka lidhje me objektet e mesiperme te veprimtarise.

2. Ne fushën e ndërtimishoqëria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tunceleve, mbikalimeve e nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujësjellësve, Ujrave mbitokësore dhe nëntokësore per energjiine dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujëtese, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe cdo ndertim tjetër i cili ne perfundim perben send te paluajshem sipas nenit H2 te Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndërtesen ku eshte vendosur.

3 Ne fushën e minierave shoqeria do te kryeje: Studimin, zbutimin, projektimin, konsulencen sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te minierave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi pubic dhe/ose privat si: ndertimin dhe shfrytezimin e minierave publike dhe private per te tera llojet e mineraleve, shfrytezimin e burimeve natyrore te ujrave minerale dhe termale; nxjerja, prodhimi, perpunimi dhe tregtimi brenda vendit e mineraleve te paperpunuara dhe te perpunuara.

4 Ne fushen e turizmit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per shfrytezimin njezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, te Shqiperise dhe me gjere, per realizimin e hoteleise, fshate turistike, qendra turistike e te tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve te nevojshem, si bar bufë-restorante, qendra estetike, palestra fitnessi, njesi te shitjeve te konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industrial e te tjera te kesaj natyre; Krijimin e agjencie turistike e te tjera.

5 Ne fushen e transportit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per transportimin

publik dhe/ose privat te njerezve dhe mallrave si dhe tranzitimin e tyre pergjate territorit te Shqiperise nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujqor, teleferik etj. Shoqeria gjithashtu do te kryeje dhe duke mos u kufizuar vetem ne, aktivitetet e meposhtme: - Ngarkim dhe shkarkim te anijeve; Pritje dhe levrime te ngarkesave nga dhe per ne anije; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim, dhe levrime i ngarkesave nga dhe neper anije.- Siper marrje dhe realizimi i cfaredolloj aktiviteti te ligjshem lidhur dhe ne sherbim te ngarkimit dhe shkarkimit te anijeve ne cdo vendankorim, ne porte. - Siper marrje, per gatitje dhe realizim i procesit te ngarkimit dhe te shkarkimit te kontenerieve, te mjeteve te tjera transportuese, te anijeve, ne interes dhe per llogari te pronarit te anijes, pergjithesisht te mjetit transportues, ne interes dhe per llogari te pronarit te ngarkeses dhe/ose te porositesit te automjeteve/ trenit, anijes 3 apo porositesve te tjere te ligjshem.- Siper marrje dhe realizim i ndermjetesimit dhe transportit, ngarkimit dhe shkarkimit te mallrave me tren e automjete ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe te Porositesve, persona te trete.- Ngarkim dhe shkarkim i trenave; Pritje dhe levrime i ngarkesave nga dhe per ne stacionet e destinuar; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim dhe levrime i ngarkesave nga dhe per transport hekurudhor dhe tokesor; - Siper marrje dhe realizimi i puneve te ndermjetesimit, agjencise dhe transportit ne interes te vete shoqerise ose te paleve te treta porositese.

6 Ne fushen e mjedisit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsultencen, siper marrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te mbrojtjes dhe ose permiresimit si dhe rehabilitimit te kushteve te mjedisit rrethues; perpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje te cdo lloji tjetër, trajtimi i ujrave industriale, projektimin, mbikqyrjen ne fushen e kerkimit dhe shfrytezimit te lendes drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftesimin dhe trajtimin e tokave te kripura e kenetave si dhe cdo veprimtari qe ka rendesi per shoqerine.

7 Ne fushen e prodhimit .

8 Ne fushen e sherbimeve.

9 Ne fushen e botimeve publikimeve dhe reklamave .

10 Ne fushen e tregtise.

11 Ne fushen e Telekomunikacionit.

12 Ne fushen e Energjise ,aktivitetin e tregetimit me pakice te karburanteve, mbajtjen e depozitave te karburanteve per efekt te aktivitetit te shoqerise per tregetimin dhe perdorimin e karburanteve per shkak te veprimtarise se saj.

3.3 Objekti i shoqerise mund te ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim te Asambleses se Pergjithshme te Aksionareve.

3.4 Shoqeria mund te ushtroje veprimtari te tjera plotesuese qe jane te dobishme ose te nevojshme per realizimin e objektit te saj, ne perputhje me ligjin shqiptar.

3.5 S Shoqeria do te bashkepunoje me persona te tjera fizike ose juridike qe ushtrojne te njjeten veprimtari ne Shqiperi ose jashte saj.

NENI 4

Selia

4.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen : Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut.

4.2 Transferimi selise se Shoqerise ne nje vend tjetër behet me vendimin e Asambleses se Pergjithshme.



4.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendose hapjen e degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

NENI 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë "PLATINIUM GROUP" SHPK është e pakufizuar dhe fillon në momentin e Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit sipas ligjit, nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

5.2 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "PLATINIUM GROUP" Shpk, priset: 5.2.1 Me vendim të asamblesë së përgjithshme.

5.2.2 Me hapjen e procedurave të falimentimit.

5.2.3 Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

5.2.4 Me vendim të gjykatës

5.2.5 Për arsye të tjera të parashikuara në statut.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT

NENI 6

Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë " PLATINIUM GROUP është 100.000 lekë.

6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100.000 leke dhe përbëhet nga 1 kuote me vlerë nominale 100.000 lek.

NENI 7

Kontributet


7.1. Sipas kontributeve të mësipërme: Ortaku i vetëm GPG COMPANY është mbajtës 100% të kuotave të kapitalit themeltar që përbejnë 1 (nje) kuote me vlerë nominale 100.000 leke.

NENI 8

Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, ortaku ka të drejtë të nënshkruajë rritjen raport me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tij.



NENI 9
Zvogëlimi i kapitalit themeltar

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga ortaku në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tij.

NENI 10
Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

10.1 Pjesët e kapitalit janë lirish të transferueshme nga ortaku tek persona fizik apo persona juridik dhe të tjerë.

10.2 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë pjesët e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë nëse do të ketë shoqëria, me letër rekomande me konfirmim marrje në dorëzim, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit ofruar për shitje.

10.3 Ortaket nëse do të ketë shoqëria, do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande me konfirmim marrje në dorëzim, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesët e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

10.4 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë nëse do të ketë shoqëria, pjesët e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në masë proporcionale me pjesët që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje ndryshe ndërmjetpalëve. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

10.5 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund të transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.

10.6 Në rast të transferimit të pjesëve të kapitalit për shkak trashëgimie kuotat do të regjistrohen në baze të nenit 43 të ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

NENI 11
Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

11.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

11.2 Asambleja e përgjithshme e shoqërisë është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të mëposhtme:

- 11.2.1 Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
11.2.2 Ndryshimin e statutit.
11.2.3 Emërimin dhe shkarkimin e administratoreve
11.2.4 Emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar.
11.2.5 Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në nenet 11.2.3 dhe 11.2.4 të këtij neni.
11.2.6 Mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
11.2.7 Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
11.2.9 Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
11.2.10 Përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve.
11.2.11 Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
11.2.12 Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë,
11.2.13 Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
11.2.14 Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në nenet 11.2.7 dhe 11.2.8 të këtij statuti pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

NENI 12

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, dhe sa here de mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme thirret nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 12.4 Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5% të asetëve të shoqërisë që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- 12.5 Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria brenda dy viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5% e asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- 12.6 Asambleja e Përgjithshme për rastet e parashikuara në nenet 13.3 dhe 13.5 të statutit i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur. Dispozitat e neneve 13.3 dhe 13.5 të këtij statuti nuk zbatohen nëse blerjet sipas këtyre parashikimeve kryhen në bursë, ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe behën në kushte normale tregu.
- 12.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

NENI 13



Mënyra e thirrjes së Asamblesë

13.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë "I" ose një njoftimi nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë ose apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithëortakeve jo më vonë se 7 dite përparaditës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

13.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas parashkrimeve të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaket nëse ka shoqëria, janë dakord, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë. Nëse shoqëria nuk ka ortake ajo merr vendime sipas parashkrimeve të mësipërme.

NENI 14

Kërkesa nga ortaket e pakicës për të thirrur asamblesë

14.1 Ortaket nëse do të kërkojnë të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblesë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë me të vogël të parashikuar në statut, mund të drejtojnë administratoreve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike për të thirrur asamblesë e përgjithshme dhe/ose për shirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet objektive dhe çështjet për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortake kanë të drejtë të thërresin asamblesë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me parashikimet e këtij statuti.

14.2 Nëse në kundërshtim me nenin 15.1 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakeve nëse do të kërkojnë shoqëria, që kanë bërë kërkesën ka të drejtë:

14.2.1 Të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakeve brenda 15 ditëve.

14.2.2 Të kërkojnë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

14.3 Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashkrimeve të nenëve 15.1 dhe 15.2, 15.2.1, 15.2.2 të këtij statuti dhe thirrja e është njoftuar ortakut të vetëm, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës të ndryshuar në përputhje me parashikimet e nenit 14.1 të këtij statuti.

14.4 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethana, të tilla që sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjera të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

NENI 15

Përfaqësimi në Asamble

15.1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblesë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një personi i tretë.

15.2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakeve në asamblesë e përgjithshme.

15.3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjes vijuese me të njëjtin rend dite.



NENI 16
Kuorumi përmarrjen e Vendimeve

16.1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë me shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë përçështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 87, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysma e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo njeje elektronike, sipas parashikimeve të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" neni 88 pika 3.

16.2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në nenin 17.1 të këtij statuti, nëse shoqëria do të ketë ortakë, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin read ditë.

NENI 17
Marrja e Vendimeve nga Asambleja e Përgjithshme

17.1 Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë me të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me % e votave të ortakëve pjesëmarrës nëse ka, siç përcaktohet në nenin 86, pika 1 e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

17.2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut përçështjet e tjera të parashikuara në nenin 81 të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

17.3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtese mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

NENI 18
E Drejta e Votës

18.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo kuote jep të drejtën e një vote.

18.2 Ortakët, nëse do të ketë, që nuk janë të pranishëm në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme kanë të drejtë të marrin pjesë me njëzetë të ndryshme komunikimi përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

18.3 Mjetet elektronike përfshijnë, por pa të kufizuar në të:

18.3.1 Transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale.

18.3.2 Komunikimin e ndërsjellët në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehin përmbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër.

18.3.3 Mekanizma, qe mundësojnë procesin e votimit përpara apo gjate mbledhjes se mbledhjes se asamblesë se përgjithshme, pa qene nevoja te caktohet një përfaqësues i autorizuar, për te marre pjese fizikisht ne mbledhje.

18.4 Ortaku i vetëm ka te drejtën qe i njihet nga ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare apo statuti i shoqërisë, për te marre unanimisht çdo vendim, me kusht qe kjo marrëveshje te behet me shkrim.

NENI 19

Përfashtimi nga e drejta e votës

19.1 Ortaku nuk mund te ushtroje te drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

19.1.1 Vlerësimin e veprimtarisë se tij.

19.1.2 Shuarjen e ndonjë detyrimi ne ngarkim te tij.

19.1.3 Ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria.

19.1.4 Dhënien ose jo te përfilitimeve te reja.

19.2 Kur ortaku përfaqësohet nga njëpërfaqësues autorizuar, i autorizuan vlerësohet te jete ne te njëjtin konflikt i interesi, ashtu si dhe ortaku te cilin përfaqëson.

NENI 20

Procesverbali i Mbledhjes se Asamblesë

20.1 Vendimet e asamblesë se përgjithshme duhet te regjistrohen ne proces verbal. Administratoret përgjigjen për ruajtjen e kopjeve te proces verbaleve te mbledhjeve te asamblesë se përgjithshme.

20.2 Procesverbali duhet te përmbajdetë të vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e te mbajtësit le procesverbalit, rezultatet e votimit.

20.3 Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes se asamblesë se përgjithshme

20.4 Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi procesverbalit

NENI 21

Administratoret

21.1 Asambleja e përgjithshme emëton një ose me shume persona fizik si administratore te shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me te drejte ripërtëritje.

21.2 Administrator i Shoqërisë "PLATINUM GROUP" shpk emërohet JETMIR MERRUKO i identifikuar me nr personal 140327051P me një afat 5 vjeçar me te drejte ripërtëritje.

21.3 Administratoret kane te drejte dhe detyrohen:

21.3.1 Te kryejnë te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e përgjithshme.

21.3.2 Te përfaqësoje shoqërinë tregtare.

21.3.3 Te kujdesen për mbajtjen e sakte dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë.

21.3.4. Te përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuarisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përshpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.

21.3.5. Te krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë rëndësinë e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

21.3.6. Te kryejnë regjistrimet dhe të dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

21.3.7. Te raportojnë para asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

21.3.8. Te kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligji dhe në statut.

21.3.9. Administraton mund të emërojnë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

21.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkaktojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të kufizojnë këtë të drejtë.

NENI 22

Përfaqësimi

22.1 Shoqëritë Tregtare përfaqësohen sipas rregullave të përcaktuara në ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të dispozitave të këtij statuti. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë është vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.

22.2 Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njostohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 23

Prishja e Shoqërisë

23.1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

23.1.1. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

23.1.2. Me vendim të asamblesë së përgjithshme;

23.1.3. Me hapjen e procedurave të falimentimit.

23.1.4. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

23.1.5 Me vendim të gjykatës

23.1.6 Për arsye të tjera të parashikuara në statut.

NENI 24

Regjistrimi i Shtëpërhyrjes

24.1 Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

24.2 Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykatë gjykatë në përputhje me ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", neni 45, ia njofton vendimi Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim.

NENI 25

Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme

25.1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortaket e tjerë nëse ka, ose shoqëria ka kryer veprime në dem të tij, nëse është përgjigjur të ushtronte të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

25.2. Ortaku nëse shoqëria është me disa ortakë, që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrorë shkaqet e largimit.

25.3. Administratori duhet të thërrasin në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dënimin për njoftimin e largimit, sipas parashikimeve të nenit 26.2 të statutit, për të vendosur nëse ortakut do të likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

25.4. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet të dëmshpërblejë shoqërinë për demet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në beze të shkaqeve të paarsyeshme.

NENI 26

Përfshirja e Ortakut

26.1. Asambleja e përgjithshme në çdo të një vendimi të zakonshëm mund të kërkojë gjykatë përfshirjen e ortakut nëse shoqëria është me disa ortakë, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për përfshirjen.

26.2. Do të konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përfshirjen e ortakut por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

26.2.1 Me dashje apo me pakujdesi të rende i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë.

26.2.2 Me dashje apo me pakujdesi të rende shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj.

26.2.3 Përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut, ose

26.2.4 Me veprimet e tij dëmton ose pengon në jeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

NENI 27

Eksperti kontabël i autorizuar

27.1. Eksperti Kontabël i Autorizuar emërohet nga Asambleja e Përgjithshme ose me Vendim Gjykatë për kontrollin e bilanceve, librave kontabël të Shoqërisë etj.

27.2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në çdo moment sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV

VITET FINANCIAR, BLANCI VJETOR, SFIPERNDARJA E FITIMEVE

NENI 28
Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 28.1. Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.
- 28.2 Viti i pare financiar fillon ne datën e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe përfundon me 31 dhjetor te të njëjtit vit.
- 28.3 Bilancet vjetore, raportet e Administratorit dhe nëse janë te nevojshme te ekspertit kontabël te autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 28.4. Miratimi i dokumenteve te lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

NENI 29
Fitimet

- 29.1. Fitimet qe rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pese për qind) qe caktohen për rezervën ligjore deri ne 10% (dhjete për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu te gjitha shumat de Asambleja e Përgjithshme vendos t'i vere ne dispozicion te shoqërisë, u shpërndahen ortakeve ne proporcion me pjesët e kapitalit themeltar te zotëruara respektivisht.
- 29.2 Asambleja e Përgjithshme mund te vendose edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtëzakonshme ose përqëllime te tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes se fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare te ardhshme.

NENI 30
Likuidimi

- 30.1 Ne rast prishje, Shoqëria do te likuidohet.
- 30.2. Për te administruar këtë procedure, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose me shume likuidatorë, te cilët do te paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohen e nevojshme për te përfunduar likuidimin.
- 30.3 Me përfundimin e procedurës se likuidimit, Asambleja e Përgjithshme do te vendose mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmëriat e punës se kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit te likuidimit.
- 30.4 Pas pagimit te kreditorëve dhe mbledhjes se kredive, likuidatori do ti shpërndaje te ardhurat përfundimtare te likuidimit ortakeve apo ortakeve ne proporcion me pjesët e kapitalit te zotëruara prej tyre ne kapitalin themeltar.

NENI 31
Dispozita te Përgjithshme


31.1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

31.2. Ky statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe pasi iu lexua ortakut të vetëm të shoqërisë, dhe u pranua vullnetarisht nënshkruhet prej tij.

ORTAKU I VETEM

GPG COMPANY

PAQSOR BUZI



GEZIMI DANI

GEZIMI DANI

